



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 221

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 27 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 117/2024, datë 12.12.2024	Për miratimin e rritjes së kuotës së Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar..... 25567
Dekret i Presidentit nr. 425, datë 23.12.2024	Për shpallje ligji..... 25567
Ligj nr. 118/2024, datë 12.12.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë për bashkëpunimin në mbrojtje ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera.... 25567
Dekret i Presidentit nr. 426, datë 23.12.2024	Për shpallje ligji..... 25574
Ligj nr. 119/2024, datë 12.12.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2021, “Për ndarjen e shoqërisë ‘Hekurudha shqiptare’ sh.a.” 25574
Dekret i Presidentit nr. 427, datë 26.12.2024	Për shpallje ligji..... 25576
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 15, datë 23.12.2024	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 11, datë 17.4.2018, “Për rregullat e brendshme mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të ministrisë së financave dhe ekonomisë” 25576
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 14.3. 2024	Rexhepi sh.p.k. kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 44789/07</i>)..... 25578

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr. 80, datë 21.11.2024

Me objekt konstatimin e cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj.

Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjyimit nga kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë, për sa i përket çështjes nr. 11118-02028-00-2016 akti, datë regjistrimi 15.6.2016, në lidhje me vendimin nr. 3048, datë 15.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 944, datë 21.4.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëshmipërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.

Konstatimin e statusit të viktimës përgjatë procesit gjyqësor, si rrjedhojë e cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj dhe afatit të arsyeshëm, në përputhje me vendimin *Scordino kundër Italisë*.

Rehabilitimin dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin, pasi dëmi/dëmtimi është shkaktuar/ka ardhur për shkak të aktit/ve të paligjshëm/me, konkretizuar saktësisht me shkresat nr. 3102/1/2020 dhe nr. 2087/1/2024 të Gjykatës së Lartë (dhjetor 2020 dhe prill 2024) dhe shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykim.

25580

Njoftim i Ministrisë për Evropën
dhe Punët e Jashtme nr. 18821,
datë 24.12.2024

Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....

25590

**LIGJ**
Nr. 117/2024**PËR MIRATIMIN E RRTJES SË
KUOTËS SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË FONDIN MONETAR
NDËRKOMBËTAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:****Neni 1**

Republika e Shqipërisë pranon rritjen e kuotës në Fondin Monetar Ndërkombëtar sipas rezolutës nr. 79-1, datë 15 dhjetor 2023, të Bordit të Guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Neni 2

1. Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për rritjen e kuotës së Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

2. Pagesa për rritjen e kuotës së Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, sipas nenit 1 të këtij ligji, kryhet nga Banka e Shqipërisë me fondet e saj.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.12.2024.

Shpallur me dekretin nr. 425, datë 23.12.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 425, datë 23.12.2024**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 117/2024, “Për miratimin e rritjes së kuotës së Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj****LIGJ**
Nr. 118/2024**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SLOVENISË PËR
BASHKËPUNIMIN NË MBROJTJE NDAJ
KATASTROFAVE NATYRORE
DHE TË TJERA**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:****Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë për bashkëpunimin në mbrojtje ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.12.2024.

Shpallur me dekretin nr. 426, datë 23.12.2024, të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SLOVENISË PËR BASHKËPUNIMIN NË
MBROJTJE NDAJ KATASTROFAVE
NATYRORE DHE TË TJERA

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
dhe

Qeveria e Republikës së Sllovenisë
(në vijim të referuara si “Palët”);

Të bindur për domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë në parandalimin dhe zbutjen e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera (në vijim e referuar si “katastrofa”);

Duke marrë parasysh rolin e Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje do të rregullojë kuadrin e kushteve për bashkëpunimin në parandalimin dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive, për ofrimin vullnetar të ndihmës së ndërsjellë në rast katastrofash në territorin e Palës tjetër, dhe format e tjera të bashkëpunimit të ndërsjellë.

2. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve ndjek parimet e reciprocitetit dhe do të zhvillohet brenda kapaciteteve të Palëve.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve përfshin kryesisht fushat e mëposhtme:

a) shkëmbimi i njohurive shkencore dhe teknike, si dhe transferimi i ekspertizës dhe përvojës në mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;

b) edukimi dhe aftësimi i personelit që merr pjesë në aktivitetet e mbrojtjes dhe shpëtimit;

c) zhvillimi dhe prodhimi i pajisjeve të mbrojtjes dhe shpëtimit;

d) njoftimi i ndërsjellë i rreziqeve nga katastrofa dhe pasojat e tyre;

e) ndihma në rast fatkeqësish në mbrojtje dhe shpëtim, si dhe në zbutjen dhe eliminimin e pasojave të tyre.

2. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe realizimin e bashkëpunimit në fushat e përmendura në paragrafin e mësipërm, Palët mund të lidhin marrëveshje zbatimi.

3. Palët zhvillojnë më tej bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kombëtare, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare dhe organizatave të angazhuara në mbrojtje nga katastrofat natyrore dhe të tjera.

Neni 3

Përkufizimet e termave

Termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimin e mëposhtëm:

a) “katastrofa natyrore dhe të tjera” janë katastrofa të shkaktuara nga forcat natyrore, veprimtaria industriale ose veprimtaria njerëzore, duke përjashtuar luftën, të cilat rrezikojnë jetën, pronën dhe mjedisin, dhe përkeqësojnë ndjeshëm kushtet e jetesës;

b) “të dhëna dhe informacione mbi rreziqet” janë të dhëna për katastrofa natyrore dhe të tjera, qëllimi i të cilave është njoftimi i hershëm i rrezikut të afërt dhe zbatimi i masave mbrojtëse dhe masave të tjera për të garantuar sigurinë për njerëzit, pronën dhe mjedisin;

c) “shpëtimi dhe zbutja e katastrofës” janë aktivitetet e të gjitha forcave dhe burimeve të shpëtimit, qëllimi i të cilave është zbutja e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë dhe eliminimi i pasojave të katastrofave natyrore dhe të tjera;



d) “ekipe shpëtimi dhe ekspertë individuale” janë ekipe dhe individë të trajnuar dhe pajisur në mënyrën e duhur, të caktuar nga shteti dërgues për ofrimin e ndihmës;

e) “pajisjet mbrojtjeje, shpëtimi dhe të tjera” janë mjete të mbrojtjes personale dhe kolektive, duke përfshirë barna dhe pajisje mjekësore, pajisje shpëtimi, mjete transporti (automjete, anije dhe avionë), dhe mjete teknike dhe të tjera të përdorura nga ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë që ofrojnë ndihmë;

f) “ndihma humanitare” është ushqimi, uji i pijshëm, barnat, pajisjet mjekësore dhe sendet e tjera të synuara për shpërndarje falas të popullata e prekur ose në rrezik si ndihmë për zbutjen e pasojave të katastrofave;

g) “Shtet pritës” është Pala, autoritetet kompetente të së cilës kërkojnë ndihmë nga fatkeqësia nga Pala tjetër;

h) “Shtet dërgues” është Pala, autoritetet kompetente të së cilës përmbushin kërkesën e Palës tjetër për ndihmë;

i) një “vend transiti” është një vend, territori i të cilit përshkohet nga ekipe shpëtimi, ekspertë individualë dhe pajisje për nevojat e Palëve.

Neni 4

Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

- në Republikën e Sllovenisë: Ministria e Mbrojtjes – Administrata e Republikës së Sllovenisë për Mbrojtjen Civile dhe Zbutjen e Katastrofave;

- në Republikën e Shqipërisë Ministria e Mbrojtjes - Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

2. Autoritetet kompetente takohen sipas nevojës për zbatimin efikas të Marrëveshjes.

3. Në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente janë të autorizuar të vendosin kontakte dhe lidhje të drejtpërdrejta. Në këtë kuadër, autoritetet kompetente do të shkëmbejnë adresat dhe të dhënat për lidhjet e telekomunikacionit (telefon, faks, postë elektronike etj.) dhe pikat e kontaktit.

4. Palët do të informojnë me shkrim njëra-tjetrën për çdo ndryshim në autoritetet kompetente dhe adresat e tyre, lidhjet telekomunikuese dhe pikat e kontaktit, jo më vonë se 30 ditë nga data e ndryshimit.

Neni 5

Bashkëpunimi ndërmjet organizatave humanitare

Palët inkurajojnë bashkëpunimin midis organizatave të tyre humanitare në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë.

Neni 6

Shkëmbimi i njohurive dhe përvojës

1. Palët informojnë njëra-tjetrën për gjetjet dhe përvojën shkencore dhe teknike, me qëllim parashikimin dhe eliminimin e pasojave të katastrofave, si dhe arritjes së mbrojtjes dhe shpëtimit më efikas, dhe garantojnë shkëmbimin dhe transferimin e ekspertizës dhe përvojës në mbrojtjen ndaj katastrofave dhe të tjera.

2. Palët shkëmbejnë informacion mbi të drejtën e brendshme të zbatueshme në fushën e mbrojtjes nga katastrofat.

3. Palët synojnë gjithashtu për përdorimin efikas të rezultateve dhe gjetjeve të bashkëpunimit shkencor dhe teknik për mbrojtjen nga fatkeqësitë në forma ekonomike dhe forma të tjera të bashkëpunimit.

Neni 7

Arsimi dhe trajnimi

Palët nxisin bashkëpunimin e ndërsjellë në edukimin dhe aftësimin e personelit që merr pjesë në aktivitetet e mbrojtjes dhe shpëtimit veçanërisht në mënyrën e mëposhtme:

a) nëpërmjet vendosjes së lidhjeve të drejtpërdrejta dhe bashkëpunimit ndërmjet organizatave arsimore dhe shkëmbimit të pedagogëve, instruktorëve dhe ekspertëve të tjerë;

b) nëpërmjet organizimit të arsimit dhe aftësimit të personelit;

c) nëpërmjet shkëmbimit të materialeve edukative dhe mësimore, si dhe përvojës së fituar gjatë aktiviteteve të mbrojtjes dhe shpëtimit;

d) nëpërmjet organizimit të ushtrimeve të përbashkëta në mbrojtje dhe shpëtim.



Neni 8

Zhvillimi dhe prodhimi i pajisjeve të mbrojtjes dhe shpëtimit

Palët inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qeveritare dhe subjekteve të biznesit në zhvillimin teknologjik dhe prodhimin e pajisjeve të mbrojtjes dhe shpëtimit.

Neni 9

Njoftimi i kërcënimeve dhe katastrofave

1. Autoritetet kompetente të Palëve informojnë njëri-tjetrin për kërcënimet dhe katastrofat që mund të kërcënojnë ose cenojnë secilën palë.

2. Njoftimi për kërcënim ose katastrofë duhet të përmbajë përshkrimin e kërcënimit ose katastrofës, informacionin për vendndodhjen, kohën, shkallën dhe pasojat e katastrofës, si dhe masat mbrojtëse të marra.

3. Në rast katastrofe, autoritetet kompetente të Palëve gjithashtu informojnë njëri-tjetrin për ndihmën e kërkuar dhe të disponueshme dhe mundësitë dhe mënyrën e ofrimit të saj.

4. Njoftimi për një kërcënim ose katastrofë mund të komunikohet me shkrim ose me gojë në gjuhën angleze. Njoftimi me gojë duhet të konfirmohet me shkrim.

5. Autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 1 të nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje do të jenë përgjegjëse për njoftimin e kërcënimeve dhe fatkeqësive dhe për dërgimin dhe marrjen e kërkesave për ndihmë.

Neni 10

Dhënia e ndihmës

1. Autoriteti kompetent i Palës së prekur nga një katastrofë mund të kërkojë ndihmë nga autoriteti kompetent i Palës tjetër. Ndihma mund të përfshijë ekipe shpëtimi dhe ekspertë individualë, pajisje mbrojtëse dhe shpëtimi dhe ndihmë humanitare.

2. Kërkesa për ndihmë sipas parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë informacion mbi llojin dhe fushën e ndihmës së kërkuar, informacion mbi institucionet dhe personat me të cilët do të vendoset kontakti dhe të cilët janë përgjegjës për pranimin e llojeve të veçanta të ndihmës, si dhe një propozim për mënyrën e ofrimit të ndihmës.

3. Përveç informacionit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, një kërkesë për ndihmë humanitare në formën e barnave dhe pajisjeve mjekësore, duhet të përfshijë një listë të të gjitha dokumenteve të nevojshme që kërkojnë nga Shteti pranues për kalimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore që hyjnë përmes kufirit të tij.

4. Ndihma jepet në përputhje me rregulloret e Palëve.

Neni 11

Kalimi i kufijve shtetërorë dhe qëndrimi në territorin e palës tjetër

1. Për të siguruar një ndihmë më të shpejtë dhe më të efektshme në mbrojtje dhe shpëtim dhe në eliminimin e pasojave të një fatkeqësie, Palët do t'u japin ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë që ofrojnë ndihmë një procedurë të thjeshtuar për kalimin e kufirit shtetëror, duke marrë parasysh kushtet e aplikueshme të hyrjes.

2. Anëtarët e ekipeve të shpëtimit dhe ekspertët individualë mund - në përputhje me rregulloret e zbatueshme të të dyja Palëve - të hyjnë në territorin e Palëve pa vizë kur kryejnë detyrat e përmendura në pikën e, paragrafi 1 të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje. Anëtarët e ekipeve të shpëtimit dhe ekspertët individualë duhet të kenë një dokument që u mundëson atyre të jenë të pranishëm në territorin e shtetit pritës dhe një listë të të gjithë anëtarëve të ekipit të shpëtimit dhe ekspertëve individualë.

3. Organet kompetente merren vesh për kohën dhe vendndodhjen e kalimit të kufirit shtetëror, për mënyrën e mbërritjes dhe nisjes, si dhe për kohëzgjatjen e qëndrimit të ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë që ofrojnë ndihmë në territorin e palës tjetër.

4. Anëtarët e ekipeve të shpëtimit dhe ekspertët individualë që ofrojnë ndihmë duhet të mbajnë dokumente zyrtare përkatëse që vërtetojnë identitetin e tyre gjatë gjithë kohës.

5. Anëtarët e ekipeve të shpëtimit dhe ekspertët individualë që ofrojnë ndihmë kanë të drejtë të veshin uniformat e tyre në territorin e Palës tjetër.

6. Ndalohet futja e armëve, municionit ose mjeteve shpërthyes në territorin e palës tjetër.

7. Objektet e krijuara për këtë qëllim do të jenë në përputhje me legjislacionin e shtetit pritës.

Neni 12

Sigurimi i transitit

1. Kur një vend i tretë i ofron ndihmë nga fatkeqësitë një Pale në përputhje me marrëveshjet përkatëse të lidhura ndërmjet tyre, kur Pala tjetër vepron vetëm si vend transiti, dispozitat e nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen, sipas rastit, për kalimin e kufirit shtetëror dhe për qëndrimin e ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë që ofrojnë ndihmë në territorin e Palës tjetër.

2. Autoritetet kompetente të Palëve, brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme, të informojnë njëri-tjetrin për kërkesat e transitit, të specifikojnë procedurat e zbatimit dhe, nëse është e nevojshme, t'u ofrojnë ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë një shoqërim të përshtatshëm gjatë transitit, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni 13

Leja e sigurisë

1. Nuk kërkohet leje sigurie për anëtarët e ekipit të shpëtimit dhe individët, ekspertët që qëndrojnë dhe punojnë në objektet ose rrethet e objekteve që kërkojnë mbikëqyrje të veçantë të lëvizjes së personelit kur kryejnë detyrat sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Përpara mbërritjes, shteti dërgues duhet t'i japë shtetit pritës një listë, emrat e të gjithë anëtarëve të ekipit të shpëtimit dhe ekspertëve individualë.

Neni 14

Importi dhe eksporti i përkohshëm i pajisjeve të mbrojtjes, shpëtimit dhe të tjera

1. Në rast fatkeqësish, Palët do të thjeshtojnë procedurat në lidhje me importin, eksportin dhe transportin e përkohshëm të mbrojtjes, shpëtimit dhe pajisjeve të tjera përtej kufirit shtetëror. Gjatë kalimit të kufirit shtetëror, drejtuesi i ekipit të shpëtimit dhe eksperti individual duhet t'i paraqesin autoritetit kompetent të shtetit pritës vetëm një listë të mbrojtjes, shpëtimit dhe pajisjeve të tjera.

2. Ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë që ofrojnë ndihmë mund të marrin përtej kufirit shtetëror vetëm ato pajisje mbrojtjeje, shpëtimi dhe të tjera që kërkohen për furnizimin dhe funksionimin e tyre.

3. Asnjë ndalim ose kufizim ndërkombëtar i zbatueshëm për importin dhe eksportin e mallrave komerciale nuk do të zbatohet për importin dhe eksportin e përkohshëm të pajisjeve të mbrojtjes, shpëtimit dhe të tjera. Nëse mbrojtja, shpëtimi dhe pajisjet e tjera mbeten të papërdorura, ato duhet t'i kthehen shtetit dërgues. Në rast të mbrojtjes, shpëtimit dhe pajisjeve të tjera që mbeten si ndihmë në shtetin pritës, autoriteti kompetent i shtetit pritës duhet të njoftohet për llojin, sasinë dhe vendndodhjen e pajisjeve në fjalë. Ky autoritet do t'ua transmetojë këtë informacion autoriteteve përkatëse doganore. Në këtë rast, do të zbatohen rregulloret e shtetit pritës, në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm.

4. Dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni do të zbatohen gjithashtu për importin e produkteve mjekësore që përmbajnë narkotikë dhe substanca psikotrope në shtetin pritës dhe për kthimin e sasive të papërdorura të tyre në shtetin dërgues. Importi dhe eksporti i narkotikëve dhe substancave psikotrope në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare nuk do të konsiderohet si import dhe eksport i mallrave në tregtinë e jashtme. Produktet mjekësore që përmbajnë narkotikë dhe substanca psikotrope mund të importohen vetëm në sasi të nevojshme për ndihmë urgjente mjekësore dhe të përdoren nën mbikëqyrjen e profesionistëve mjekësorë me trajnim të duhur mjekësor në përputhje me rregulloret e shtetit dërgues dhe bazuar në listën e këtyre produkteve mjekësore, ose me recetë për këto barna.

5. Palët do të thjeshtojnë procedurat në lidhje me importin, eksportin dhe transportin e përkohshëm të mbrojtjes, shpëtimit dhe pajisjeve të tjera përtej kufirit shtetëror për kryerjen e arsimit dhe trajnimit të përbashkët në mbrojtje dhe shpëtim sipas nenit 7 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15

Përdorimi i avionëve dhe anijeve

1. Avionët dhe anijet mund të përdoren për transport emergjent të ekipeve të shpëtimit ose ekspertëve individualë që ofrojnë pajisje ndihme, mbrojtjeje, shpëtimi dhe të tjera, dhe lloje të tjera të ndihmës në përputhje me këtë Marrëveshje.

2. Autoriteti kompetent i Shtetit pritës duhet të informohet menjëherë për dhënien e ndihmës në rast katastrofe dhe përdorimin e avionëve dhe



anijeve për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe t'i jepet informacion i detajuar për llojet dhe kodet e avionëve ose anijeve, ekuipazhet e tyre, ngarkesën, dhe parametrat e tjerë të kërkuar. Shteti pritës specifikon kohën, fluturimin e planifikuar ose itinerarit e navigimit dhe vendin e mbërritjes.

3. Dispozitat e nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me kalimin e kufirit shtetëror zbatohen sipas rastit për ekuipazhet e avionëve dhe anijeve, si dhe për ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë që ofrojnë ndihmë. Dispozitat e nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen për transportin e avionëve dhe anijeve, pajisjet e mbrojtjes dhe shpëtimit, si dhe për ndihmat në fatkeqësi.

4. Ligjet dhe rregulloret e njëres Palë që rregullojnë hyrjen dhe nisjen nga territori i saj i avionëve të përfshirë në operacione humanitare dhe kërkim-shpëtim dhe operimin dhe lundrimin e avionëve të tillë ndërsa janë brenda territorit të saj, do të zbatohen për avionët e Palës tjetër. Çdo plan fluturimi duhet të përmbajë informacionin e kërkuar në lidhje me fluturimin e planifikuar të avionit ose një pjesë të tij dhe duhet t'i dorëzohet njërive të Shërbimit të Trafikut Ajror. Palët do të detyrohen nga standardet dhe udhëzimet e zbatueshme në një shtet individual.

5. Rregulloret e Palëve në lidhje me lundrimin në rrugët ujore të brendshme dhe rregulloret dhe standardet ndërkombëtare do të zbatohen për përdorimin e anijeve.

Neni 16

Përdorimi i avionëve ushtarakë dhe anijeve ushtarake

Përdorimi i avionëve ushtarakë dhe anijeve ushtarake për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje lejohet vetëm në marrëveshje me shtetin pritës.

Neni 17

Autoritetet përgjegjëse për menaxhimin

1. Autoritetet kompetente të Shtetit pritës janë në të gjitha rastet përgjegjës për menaxhimin e operacioneve të shpëtimit dhe ofrimin e ndihmës.

2. Autoritetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni u japin detyra vetëm kryetarëve të ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë të shtetit dërgues, të cilët nga ana e tyre do të informojnë vartësit e tyre për hollësitë e ekzekutimit të detyrave.

Neni 18

Marrja e mbështetjes shtetërore për operacionet e ekipeve të shpëtimit dhe të ekspertëve individualë

Autoritetet e shtetit pritës do të ofrojnë mbështetje gjithëpërfshirëse për ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë të shtetit dërgues që kryejnë detyra mbrojtjeje dhe shpëtimi dhe ofrojnë ndihmë.

Neni 19

Kostoja e ndihmës

1. Shteti dërgues nuk ka të drejtë të kërkojë kompensimin e kostove nga Shteti pranues për ndihmën e dhënë. Kjo zbatohet gjithashtu për kostot e shkaktuara përmes përdorimit, dëmtimit ose humbjes së pajisjeve të mbrojtjes, shpëtimit dhe të tjera, duke përfshirë mjetet e transportit.

2. Shpenzimet e ndihmës të ofruara nga persona juridikë ose fizikë nëpërmjet Shtetit dërgues mbulohen nga Shteti pritës. Shteti pritës duhet ta kërkojë këtë ndihmë drejtpërdrejt dhe të pranojë të kompensojë kostot e ndihmës së dhënë.

3. Mjetet e transportit që përdoren për dhënien e ndihmës përjashtohen nga pagesa për shfrytëzimin e infrastrukturës së transportit dhe pagesat e mundshme ose kontributet e tjera.

4. Nëse ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë që ofrojnë ndihmë u mbarojnë furnizimet që kanë sjellë me vete, shteti pritës do të mbulojë shpenzimet e mirëmbajtjes së tyre, akomodimit dhe furnizimeve të nevojshme deri në përfundimin e detyrës së tyre të ndihmës. Nëse është e nevojshme, atyre do t'u ofrohet mbështetje e përshtatshme logjistike dhe kujdes mjekësor.

5. Para se të mbërrijnë në territorin e Shtetit pritës, ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë që ofrojnë ndihmë duhet të kenë sigurimin e duhur shëndetësor për të mbuluar kostot e mundshme të trajtimit.

Neni 20

Rimbursimet dhe zhdëmtimet

1. Palët heqin dorë nga të gjitha pretendimet për rimbursim për dëmtimin e pajisjeve të mbrojtjes, shpëtimit dhe të tjera, me kusht që dëmi i përmendur të jetë shkaktuar nga ekipi i shpëtimit ose



eksperti individual që ndihmon në kryerjen e detyrave të shpëtimit dhe lehtësimit nga katastrofat sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dëmi nuk ka qenë i qëllimshëm.

2. Palët do të heqin dorë nga çdo e drejtë për rimbursim në rastin e lëndimeve personale dhe pasojave të përhershme për shëndetin, dhe në rastin e vdekjes së një pjesëmarrësi në një operacion shpëtimi, nëse kjo ndodh gjatë kryerjes së detyrave të shpëtimit sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç në rastet kur dëmi shkaktohet me dashje.

3. Në rastin e dëmit të shkaktuar personave të tretë gjatë kryerjes së detyrave të mbuluara nga kjo Marrëveshje, Shteti pritës do të marrë përgjegjësinë sikur dëmi të jetë shkaktuar nga ekipet e tij të shpëtimit dhe ekspertët individualë që ofrojnë ndihmë, përveç rasteve kur dëmi është shkaktuar me dashje nga ekipet e shpëtimit të shtetit dërgues ose ekspertë individualë që ofrojnë ndihmë.

4. Detyrimi për zhdëmtim i përcaktuar në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni lind pas mbërritjes në territorin ose hapësirën ajrore të Shtetit pritës dhe vazhdon deri në largimin nga territori i tij ose hapësira ajrore.

5. Palët do të zbatojnë gjithashtu dispozitat e këtij neni në rast se ato janë vende transiti.

Neni 21

Mbrojtja e informacionit dhe e të dhënave

Informacioni dhe të dhënat e marra gjatë kryerjes së detyrave sipas kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të informacionit dhe të dhënave që nuk lejohen të shkëmbehen, publikohen ose shpërndahen lirisht në përputhje me legjislacionin e Palëve, mund të shkëmbehen, publikohen ose transmetohen te persona të tjerë juridikë dhe fizikë në përputhje me rregulloret e të dyja Palëve, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe nga autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 22

Përdorimi i informacionit dhe mjetet e komunikimit

1. Autoritetet kompetente të Palëve sigurojnë lidhje të ndërsjella informimi dhe komunikimi, veçanërisht lidhje telefonike, në radio dhe lidhje të tjera me ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë që ofrojnë ndihmë, në përputhje me këtë

Marrëveshje, duke respektuar rregullat e komunikimit të pranuar ndërkombëtarisht. Autoritetet kompetente të Palëve ofrojnë gjithashtu akses në internet.

2. Palët shkëmbejnë listat e frekuencave të radios të autorizuar për t'u përdorur në territoret e tyre për qëllime të komunikimit të ndërsjellë, bazuar në marrjen paraprake të licencave të radios.

Neni 23

Ndikimi i kësaj marrëveshjeje mbi marrëveshjet e tjera

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare.

Neni 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët i zgjidhin mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, ekskluzivisht me konsultime dhe negociata të ndërsjella.

Neni 25

Ndryshimet

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të të dyja palëve. Çdo amendament i Marrëveshjes do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 26, paragrafi 2.

2. Njoftimet me shkrim nga Palët në lidhje me ndryshimet në të dhënat për autoritetet kompetente dhe adresat e tyre, lidhjet e telekomunikacionit dhe pikat e kontaktit nuk do të konsiderohen si amendamente të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 26

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë kohore të pacaktuar.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilin Palët informojnë njëra-tjetrën se kërkesat e brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi, janë përmblusur.

3. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë me shkrim përmes



kanaleve diplomatike duke i dhënë një njoftim me shkrim tre muajsh për përfundimin Palës tjetër.

4. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të paragjykojë detyrimet në lidhje me zbatimin e saj, të cilat janë ende të zbatueshme në datën e përfundimit të saj.

1.Bërë në Bruksel, më 13 qershor 2024, në dy origjinale në gjuhën angleze.

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së
Shqipërisë:

Për Qeverinë e
Republikës
së Sllovenisë:

DEKRET

Nr. 426, datë 23.12.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 118/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë për bashkëpunimin në mbrojtje ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 119/2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 90/2021, “PËR NDARJEN E SHOQËRISË ‘HEKURUDHA SHQIPTARE’ SHA”

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 90/2021, “Për ndarjen e shoqërisë ‘Hekurudha shqiptare’ sh.a.” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

1. Në nenin 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a., ndahet në dy shoqëri pritëse si më poshtë:

a) shoqëria aksionare për infrastrukturën hekurudhore (në vijim administruesi i infrastrukturës);

b) shoqëria aksionare hekurudhore për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, si dhe për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (në vijim sipërmarrësi hekurudhor).”.

b) Në pikën 2 fjalët “ministra përgjegjëse për ekonominë” zëvendësohen me fjalët “ministra përgjegjëse për transportin hekurudhor”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Përgjegjësitë e sipërmarrësit hekurudhor

1. Sipërmarrësi hekurudhor është përgjegjës për administrimin, funksionimin e shërbimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të transportit hekurudhor të udhëtarëve nëpërmjet lokomotivave dhe vagonëve të udhëtarëve, të blerë ose të marrë me qira, duke garantuar:

a) performancën e lartë të këtij lloji transporti;

b) miradministrimin e aseteve të mjeteve lëvizëse.

2. Sipërmarrësi hekurudhor është përgjegjës për administrimin, funksionimin e shërbimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të transportit hekurudhor të mallrave dhe mjeteve të kombinuara të transportit, në kuptimin e transportit multimodal, nëpërmjet lokomotivave e vagonëve, të blerë ose të marrë me qira, duke garantuar:

a) kryerjen e transportit të mallrave;



b) rregullimin ligjor të transportit hekurudhor të mallrave;

c) miradministrimin e regjistrave të mjeteve dhe planit të aseteve të mjeteve tërheqëse e lëvizëse.

3. Sipërmarrësi hekurudhor është përgjegjës për modernizimin, riparimin, përmirësimin, rinovimin dhe rindërtimin e elementeve përbërëse të ndërveprimit të mjeteve hekurudhore tërheqëse dhe lëvizëse, të rënda e të lehta.

4. Sipërmarrësi hekurudhor është përgjegjës për mirëmbajtjen e asaj infrastrukture, që i përket planit të aseteve të administruara prej tij, si dhe të objekteve të destinuar për ofrimin e shërbimeve hekurudhore dhe shërbimeve të tjera nëpërmjet:

a) realizimit të ndërveprimit, si aftësi e sistemit hekurudhor për të lejuar përdorim të sigurt dhe të pandërprerë të mjetit hekurudhor, që përmbush nivelet e kërkuara të performancës për ato linja;

b) garantimit të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, të harmonizuara në atë shqiptar për zbatimet hekurudhore, pas rindërtimit të mjetit hekurudhor, i cili do të pajiset me autorizim për futjen në shërbim të mjetit;

c) lëshimit të faturave për shërbimet për të tretët dhe mbledhjes së tarifave të këtyre shërbimeve nga subjekti përgjegjës, i certifikuar për mirëmbajtjen e mjetit hekurudhor.

5. Ministri përgjegjës për transportin hekurudhor dhe sipërmarrësi hekurudhor lidhin kontratën e shërbimit publik për të garantuar që shërbimi i transportit hekurudhor i udhëtarëve, si një shërbim me interes të përgjithshëm, të ofrohet me kapacitet sa më të lartë, të jetë sa më i sigurt, sa më cilësor ose i ofruar me çmime më të ulëta sesa ato të tregut të hapur.

6. Sipërmarrësi hekurudhor mund të jetë përftues i së drejtës ekskluzive për të ofruar shërbimin publik për transportin e udhëtarëve me hekurudhë.

7. Sipërmarrësi hekurudhor është përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrat të mjeteve, ku është shënuar edhe sipërmarrësi përgjegjës për mirëmbajtjen e mjeteve të tij.”

Neni 3

Nenet 4 dhe 5 shfuqizohen.

Neni 4

1. Në nenin 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ministria përgjegjëse për transportin hekurudhor realizon ndarjen e shoqërisë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

b) Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me këtë përmbajtje:

“3/1. Ministri përgjegjës për transportin hekurudhor cakton ekspertët përkatës për vlerësimin e shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., dhe krijimin e dy shoqërive të reja.

3/2. Dy shoqëritë e reja regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit brenda 6 muajve nga miratimi i raporteve përfundimtare të ekspertëve, të caktuar nga ministri përgjegjës për transportin hekurudhor.”

c) Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Pasuritë e shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., ndahen dhe i alokohen si pronësi në administrim të dy shoqërive të reja, që krijohen përmes akteve të veçanta dhe të drejtpërdrejta të transferimit të pronësisë, midis ministrit përgjegjës për administrimin e pronave publike dhe shtetërore, në emër të Republikës së Shqipërisë, dhe përkatësisht shoqërisë aksionare për infrastrukturën hekurudhore dhe shoqërisë aksionare hekurudhore për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, si dhe për mirëmbajtjen mjeteve lëvizëse.”

Neni 5

Në paragrafin e parë të nenit 8 fjalët “ministri përgjegjës për ekonominë” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për transportin hekurudhor”.

Neni 6

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Për një periudhë 12-mujore nga regjistrimi i dy shoqërive në Qendrën Kombëtare të Biznesit, shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a., do të mbikëqyrë veprimtarinë e dy shoqërive të reja dhe përmbushjen e përgjegjësi të përcaktuara sipas këtij ligji.

2. Shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a., çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit me



përfundimin e periudhës 12-mujore, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Shoqëritë pritëse janë pasardhëset ligjore të shoqërisë “Hekurudha shqiptare”, sh.a., për sa i përket transferimit të pasurive dhe të gjitha të drejtave e detyrimeve të tjera.

4. Shoqëria aksionare hekurudhore për transportin e udhëtarëve e të mallrave dhe për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse bën kërkesën për licencat përkatëse, certifikatat dhe lejet e tjera, në përputhje me përcaktimet në Kodin Hekurudhor, jo më vonë se 180 ditë nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. Administruesi i infrastrukturës bën kërkesën për licencë dhe autorizim të sigurisë hekurudhore sipas Kodit Hekurudhor.”

Neni 7

Kudo në ligj fjalët “katër shoqërive” dhe “katër kompanive” zëvendësohen me fjalët “dy shoqërive”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.12.2024.

Shpallur me dekreten nr. 427, datë 26.12.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 427, datë 26.12.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 119/2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2021, ‘Për ndarjen e shoqërisë ‘Hekurudha shqiptare’ sh.a.’”

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM

Nr. 15, datë 23.12.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 11, DATË 17.4.2018, “PËR RREGULLAT E BRENDSHME MBI MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË MINISTRISË SË FINANCave DHE EKONOMISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 510, 589, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 43, 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 152, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 11, datë 17.4.2018, “Për rregullat e brendshme mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në titullin e udhëzimit, togfjalëshi “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me togfjalëshin “ministria përgjegjëse për financat”.

2. Në pikën 6, të kreut II, togfjalëshi “çështje të pronës publike dhe”, hiqet.

3. Pika 8, e kreut II, ndryshon si më poshtë vijon:

“8. *Struktura përgjegjëse për financat, pas marrjes së dokumentacionit nga struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore së bashku me kërkesën e miratuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësorë, bën verifikimin e fondeve buxhetore dhe radhës së pagesës, sipas data bazës të përvjellë nga struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore, dhe i paraqet nëpunësit autorizues propozimin për miratimin e kërkesës së pagesës që shoqërohet me aktin financiar, në kuadër të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.*

4. Në të gjithë përmblajtjen e udhëzimit, togfjalëshi “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me togfjalëshin “ministria përgjegjëse për financat”.


5. Në aneksin 1, “Gjurma e Auditimit për procedurat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore”, faqe 3,



zëvendësohet me faqen 3, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
Petrit Malaj





GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 44789/07
REXHEPI SHPK
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 13 shkurt 2023 si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 44789/07) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”), më 29 shtator 2007 nga Rexhepi sh.p.k. (“kërkues”), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. K. Puto, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga Agjentja znj. A. Hiçka, dhe më pas nga Agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të së drejtës së shoqërisë kërkuese për gjykim të drejtë dhe të së drejtës së saj për gëzimin e qetë të pasurisë së saj.

2. Shoqëria kërkuese ka lidhur një *kontratë sipërmarrjeje* me personat privatë B. dhe S. për ndërtimin e një objekti në truallin e tyre. Më pas, Këshilli i Planifikimit të Territorit i Bashkisë Tiranë (këtu e më tutje “KPT Tiranë”) i dha kërkuesit një leje planifikimi (më 26 nëntor 1997) dhe një leje ndërtimi (më 22 dhjetor 1997). Vlefshmëria e lejes së ndërtimit u zgjat më pas në dy raste (më 24 gusht 1998 dhe më 23 qershor 2000) deri më 23 qershor 2005.

3. Në mars 2003, një tjetër shoqëri tregtare D. lidhi marrëveshje me A., K. dhe T. për ndërtimin e një objekti në truallin e tyre. Më pas, KPT Tiranë i

dha shoqërisë tregtare D. një leje planifikimi (më 9 maj 2003) dhe një leje ndërtimi (28 maj 2004).

4. Duket se trualli në pronësi të A., K. dhe T. mbivendoset me atë në pronësi të B. dhe S.

5. Nuk është e qartë se në cilin moment shoqëria kërkuese mësoi për lejet që ju dhanë shoqërisë tregtare D. Megjithatë, më 14 korrik 2004 shoqëria kërkuese depozitoi një padi në Gjykatën e Rrethit Tiranë (“Gjykata e Rrethit”) kundër KPT-së Tiranë dhe D. ku kërkoi anulimin e lejeve të planifikimit dhe ndërtimit të kësaj të fundit.

6. Më 11 shtator 2004, Këshilli Kombëtar për Planifikimin e Territorit (këtu e më tutje “KPT Kombëtar”) anuloi lejet e planifikimit dhe ndërtimit që i ishin dhënë shoqërisë kërkuese mes viteve 1997 dhe 2000. KPT-ja Kombëtar vlerësoi se rinovimi i vlefshmërisë së lejes së ndërtimit të kërkuesit dhe zgjatja e mëtejshme e vlefshmërisë së saj kishte qenë e paligjshme.

7. Më 27 janar 2005, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi në favor të shoqërisë kërkuese dhe anuloi lejet e planifikimit dhe ndërtimit që ju dhanë shoqërisë D. Ajo konstatoi, *inter alia*, se leja e ndërtimit e shoqërisë kërkuese kishte qenë e ligjshme dhe se anulimi i saj nga KPT Kombëtar duhej shpallur i pavlefshëm (*veprim juridik absolutisht i pavlefshëm*). Kundër këtij vendimi u ankua KPT Kombëtar dhe shoqëria tregtare D.

8. Më 12 maj 2005, Gjykata e Apelit rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe hodhi poshtë pretendimin e shoqërisë kërkuese. Ajo u shpreh se, duke iu referuar disa proceseve të mëparshme gjyqësore që trajtonin këtë çështje, pronarët e rinj të truallit të tokës për të cilin ishin dhënë lejet për shoqërinë kërkuese ishin A., K. dhe T. dhe jo B. dhe S. Rrjedhimisht, KPT-ja Tiranë i kishte dhënë leje shoqërisë tregtare D., duke pasur parasysh marrëveshjen e saj me A., K. dhe T. Gjithashtu, shoqëria kërkuese kishte paraqitur padinë e saj civile përtej afatit tridhjetë ditor të ankimimit kundër akteve administrative të KPT-së Tiranë. Shoqëria kërkuese nuk kishte *locus standi* pasi i ishte hequr lejet me anë vendimin e KPT-së Kombëtar të 11 shtatorit 2004. Gjykata e apelit nuk pranoi arsyetimin e Gjykatës së Rrethit për shpalljen e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KPT-së Kombëtar. Ajo konstatoi se çdo ankim kundër vendimit të KPT-së Kombëtar duhej të ishte depozituar në një proces të veçantë gjyqësor.



9. Më 14 prill 2006, Gjykata e Lartë e shpalli ankimin e mëtejshëm të kërkuarit të papranueshëm dhe më 9 korrik 2007, Gjykata Kushtetuese, e mbledhur me trupë të plotë, rrëzoi ankimin kushtetues të shoqërisë kërkuar duke konstatuar se nuk kishte pasur shkelje të së drejtës së saj për një seancë gjyqësore të drejtë.

10. Në një datë të panjohur, shoqëria kërkuar depozitoi një kërkesë për rishikim të vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 12 maj 2005. Kjo kërkesë u nxit nga pushimi i procesit penal kundër një nëpunësi të Bashkisë Tiranë, i cili ishte i dyshuar për shpërdorim detyre dhe falsifikim të dokumenteve zyrtare, veçanërisht vendimin e 23 qershorit 2000 të KPT-së Tiranë (shihni paragrafin 2 më lart). Gjykata e Apelit, kur vendosi pushimin e procesit penal, kishte konstatuar se vendimi i KPT-së Tiranë i datës 23 qershor 2000 nuk ishte i falsifikuar, por ishte nxjerrë në përputhje me ligjin. Gjykata e Lartë hodhi poshtë kërkesën e shoqërisë kërkuar për rishikim.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

11. Shoqëria kërkuar u ankua, së pari, se dhënia e lejeve të planifikimit dhe ndërtimit për shoqërinë tregtare D., dhe së dyti, se anulimi i lejeve të saj të planifikimit dhe ndërtimit nga KPT-ja Kombëtar shkelnin të drejtat e saj sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

12. Qeveria argumentoi se shoqëria kërkuar nuk kishte arritur të shteronte mjetet juridike të brendshme. Ajo u shpreh se proceset e brendshme gjyqësore që kishte ndjekur kërkuar kishin të bënin me të drejtat e shoqërisë D. për të ndërtuar në truallin në fjalë. Kërkuar nuk kishte ankimuar vendimin e KPT-së Kombëtar të cilin e konsideronte se kishte ndërhyrë në të drejtat e tij. Në çdo rast, vendimi i anulimit i KPT-së Kombëtar thjesht kishte korrigjuar situatën e mëparshme të paligjshme dhe për rrjedhojë nuk kishte ndërhyrë në të drejtat e kërkuarit sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 ose, përndryshe, ndërhyrja kishte qenë e justifikuar.

13. Shoqëria kërkuar, nga ana tjetër, argumentoi se vendimi i KPT-së Kombëtar duhej të konsiderohej “absolutisht i pavlefshëm”. Ajo pohoi se e kishte ngritur këtë argument para gjykatave të brendshme.

14. Gjykata konstaton se leja e planifikimit së bashku me lejen e ndërtimit të lëshuar më pas

përbënin “pasuri” për shoqërinë kërkuar (shihni *Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 9074/07, §§ 98-99, 23 mars 2010).

15. Edhe nëse supozohet se dhënia e lejeve të planifikimit dhe ndërtimit për shoqërinë D. përbënte shkak të veçantë për ndërhyrje në interesin pasuror të shoqërisë kërkuar (krahasoni *Mullai dhe të tjerët*, cituar më lart, § 111), Gjykata vlerëson se, për shkak të fakteve specifike të çështjes në fjalë, thelbi i kërkesës së kërkuarit sipas nenit 1 të Protokollit Nr.1 është fakti që lejet e tij të planifikimit dhe të ndërtimit ishin shfuqizuar nga KPT Kombëtar. Gjykata nuk mund të mos vërë re, siç bëri Gjykata e Apelit (shih paragrafin 8 më lart), se lejet e shoqërisë kërkuar sidoqoftë u shfuqizuan menjëherë pasi shoqërisë D. iu dhanë lejet e planifikimit dhe ndërtimit.

16. Për sa i përket vendimit të KPT-së Kombëtar për anulimin e lejeve të planifikimit dhe ndërtimit të kërkuarit, Gjykata bie dakord me Qeverinë se kërkuar, duke mos ngritur asnjë padë kundër këtij vendimi, nuk ka shteruar mjetet e brendshme juridike. Megjithatë kërkuar e konsideroi vendimin e goditur si absolutisht të pavlefshëm (dhe në fakt këtë e parashtrroi para gjykatave të brendshme), Gjykata nuk ka asnjë arsye të vërë në dyshim konstatimin e Gjykatës së Apelit sipas të cilës çdo argument kundër vendimit të KPT-së Kombëtar duhej të ishte paraqitur në proces të veçantë gjyqësor kundër aktit në fjalë.

17. Rrjedhimisht, ankesa e shoqërisë kërkuar në lidhje me ndërhyrjen për shkak të anulimit të lejeve të saj të planifikimit dhe ndërtimit duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrimin e mjeteve të brendshme juridike.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

18. Shoqëria kërkuar pretendoi shkelje të nenit 6 § 1, duke shprehur pakënaqësinë e saj me arsyetimin e gjykatave të brendshme dhe me rezultatin e procesit kundër KPT-së Tiranë dhe shoqërisë D. Ajo vlerësoi se KPT-ja Kombëtar kishte ndërhyrë në mënyrë të paligjshme në çështjen e saj duke anuluar lejet e saj të planifikimit dhe ndërtimit. Kërkuar kundërshtoi gjithashtu pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit dhe konsideroi se i kishte munguar qasja në gjykatë nisur nga vendimi i Gjykatës së Apelit.



19. Qeveria argumentoi se proceset e brendshme gjyqësore kishin përmbushur garancitë e gjykimit të drejtë të ofruara nga neni 6 i Konventës.

20. Për sa i përket ankesës në lidhje me pretendimin e anshmërisë dhe mungesës së pavarësisë së gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, shoqëria kërkuese duket se e mbështet këtë pretendim në dyshimet që Gjykata e Apelit kishte vepruar me nxitim, që kishte pranuar ankimin e paraqitur nga përfaqësuesi i palës kundërshtare pa prokurë të vlefshme nga ky i fundit dhe që kishte refuzuar pezullimin e procesit të kundërshtuar në pritje të përfundimit të procesit penal kundër një nëpunësi të Bashkisë Tiranë (shihni paragrafin 10 më lart). Gjykata nuk e sheh se si pretendimet e sipër-përshkruara – edhe nëse janë gjetur të vërteta – mund të prekin paanshmërinë dhe pavarësinë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit.

21. Për sa i përket pretendimit në lidhje me qasjen në gjykatë, Gjykata vlerëson se shoqëria kërkuese kishte mundësi që të paraqiste pretendimet e saj në gjykatat e brendshme dhe se në fakt këto gjykata i shqyrtuan ato pretendime. Duke vënë në dukje se thelbi i ankesës së kërkuarit duket se lidhet me vendimin e Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se megjithëse ajo gjykatë hodhi poshtë pretendimet e tij për mungesë legjitimiti dhe për paraqitjen e kërkesave jashtë afatit, ajo gjithsesi e trajtoi themelin e pretendimeve të kërkuarit (shihni paragrafin 8 më lart). Siç u përmend më lart, çdo argument kundër vendimit të KPT-së Kombëtar duhej të ishte paraqitur kundër atij akti në një proces të veçantë gjyqësor.

22. Për sa i përket arsyeve mbi të cilat mbështeten gjykatat e brendshme dhe duke theksuar se padia e shoqërisë kërkuese është refuzuar (shihni paragrafin 10 më lart), nuk ka shkaqe për gjetjen e shkeljes së nenit 6 të Konventës. Duke theksuar se, si rregull, funksioni i Gjykatës nuk është të merret me gabimet e pretenduara të ligjit ose fakteve që janë kryer nga gjykatat kombëtare (shihni *De Tommaso kundër Italisë* [DHM], nr. 43395/09, § 170, 23 shkurt 2017), Gjykata vëren se gjykatat e brendshme në rastin konkret kanë dhënë arsye për vendimet e tyre, të cilat nuk duket se janë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Meqenëse Gjykata e Apelit gjeti se çdo ankim kundër vendimit të KPT-së Kombëtar duhej të ishte objekt i një procesi të veçantë gjyqësor kundër atij vendimi (shih paragrafin 8 më lart), nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme që gjykata e

apelit nuk u shpreh më pas për arsyet e shfuqizimit të lejeve të planifikimit dhe ndërtimit të shoqërisë kërkuese. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë për të refuzuar *de plano* ankimin e shoqërisë kërkuese për çështjet ligjore pa dhënë arsye të shtjelluara nuk përbën shkelje të nenit 6 § 1 (shihni *çështja Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, § 106, 18 dhjetor 2007).

23. Për rrjedhojë, kjo pjesë e kërkesës është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,
Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 14 mars 2024.

Olga Chernishova
Zëvendëskancelare

Georgios A. Serghides
President

VENDIM Nr. 80, datë 21.11.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 21.11.2024,
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (Z) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT ARB” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori, Alban Ruli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

BANKA KOMBËTARE TREGTARE, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, Ndue Maluta.

KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE sh.a., në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj.



Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimi i procedurës së gjyimit nga kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë, për sa i përket çështjes nr. 11118-02028-00-2016 akti, datë regjistrimi 15.6.2016, në lidhje me vendimin nr. 3048, datë 15.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 944, datë 21.4.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëshmipërblimin dhe përsheptimin e procedurave të sipërpërmendura.

Konstatimi i statusit të viktimës përgjatë procesit gjyqësor, si rrjedhojë e cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj dhe afatit të arsyeshëm, në përputhje me vendimin *Scordino kundër Italisë*.

Rehabilitimi dhe zhdëmtimi në përputhje me ligjin, pasi dëmi/dëmtimi është shkaktuar/ka ardhur për shkak të aktit/ve të paligjshëm/me, konkretizuar saktësisht me shkresat nr. 3102/1/2020 dhe nr. 2087/1/2024 të Gjykatës së Lartë (dhjetor 2020 dhe prill 2024) dhe shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykim.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 44, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuës, shoqërisë “Zyra e Përmbartimit Privat ARB” sh.p.k. (*kërkuësja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Bankës Kombëtare Tregtare (BKT), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjektit tjetër të interesuar, Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja ka lidhur kontratë shërbimi me KESH-in për ekzekutimin e vendimit “Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit” nr. 9031 akti, datë 13.9.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*urdhri i ekzekutimit*), për faturën tatimore të shitjes nr. 248/2012 dhe nr. 254/2012, e cila ka korrigjuar të parën. Në bazë të asaj kontrate kërkuësja ka filluar procedurën për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit në favor të KESH-it si kreditor me debitore shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (CEZ). Pas lajmërimit për ekzekutimin vullnetar të urdhrit të ekzekutimit, kërkuësja ka lëshuar urdhrin për vënien e sekuestros konservative drejtuar bankave të nivelit të dytë.

2. Kërkuësja ka pretenduar se BKT-ja nuk ka përmbushur urdhërimet e saj për debitimin e llogarisë së debitorit në atë bankë, me qëllim pengimin e zbatimit të urdhrit të ekzekutimit. Në këto kushte, më datë 28.5.2014, ajo ka paditur në gjykatë BKT-në, ndaj së cilës ka kërkuar shpërblim për dëmin pasuror e jopasuror të pësuar, për fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore përkatëse sipas normës Tribor njëditor të vendosur nga Banka e Shqipërisë, deri më datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës. Kërkimin për dëmin pasuror kërkuësja e ka bazuar në moskontraktimet e mëtejshme të saj nga KESH-i dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST).

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3048, datë 15.4.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuës, pasi nuk u vërtetua ekzistenca e ndonjë dëmi pasuror që t'i ketë ardhur paditëses (kërkuës) nga i padituri. Ajo gjykatë, ndër të tjera, ka arsyetuar se pretendimi për moslidhjen e kontratave të mëtejshme, në kushtet kur nuk është vërtetuar asnjëherë se ka ekzistuar një vullnet i tillë nga pala tjetër kontraktore, është i pabazuar në ligj dhe bie në kundërshtim me parimin e lirisë kontraktore.

4. Mbi ankimin e kërkuës, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 944, datë 21.4.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

5. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, më datë 20.5.2016, kërkuësja ka ushtruar rekurs. Çështja



është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11118-02028-00-2016, datë 15.6.2016 dhe ende nuk është gjykuar.

6. Më datë 14.12.2020, kërkesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë, bazuar në nenet 399/1-399/12, të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Me shkresën nr. 3102/1 prot., datë 21.12.2020 “Kthim përgjigje për konstatim shkelje afati të arsyeshëm”, kancelari i Gjykatës së Lartë ka njoftuar kërkuuesen se kërkesa e saj nuk ishte nënshkruar nga një avokat i pajisur me akt përfaqësimi, sipas nenit 474 të KPC-së dhe, në këto kushte, e ka kthyer atë pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse. Në vijim, më datë 30.12.2020 kërkesja ka paraqitur sërish në Gjykatën e Lartë një kërkesë me të njëjtin objekt dhe përmbajtje si ajo e datës 14.12.2020, të nënshkruar si nga administratori i shoqërisë, ashtu edhe nga një avokat. Ajo kërkesë është regjistruar me nr. 7 regjistri dhe 30.12.2020 datë regjistrimi.

7. Në përgjigje të kërkesës për informacion të kërkuueses, me shkresën nr. 1008/1 prot., datë 1.4.2021 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, ajo është njoftuar se të dyja çështjet e saj ishin në fazën e studimit për t’u shqyrtuar në dhomën e këshillimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

8. Duke pretenduar se Gjykata e Lartë ishte në vonesë si për shqyrtimin e çështjes civile, ashtu edhe për shqyrtimin e kërkesës së saj për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, kërkesja, më datë 21.4.2021 ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar: (i) konstatimin e cenimit të aksesit nga një gjykatë e caktuar me ligj; (ii) konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile dhe shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm; (iii) konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëshmipërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura (*kërkesa nr. 1*).

9. Gjykata, me vendimin nr. 34, datë 1.11.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se nuk ka rezultuar që kërkesja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së paditur, për të cilat pretendon se kanë shkaktuar moslidhjen në vijimësi të kontratave të mëtejshme të shërbimit me shoqëritë KESH dhe OST. Në përfundim, Gjykata ka vlerësuar se edhe pse duket se deri diku ka një

tejzgjatje të procesit, duke konsideruar rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuueses, si dhe numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë në pritje për t’u gjykuar nga një numër i reduktuar gjyqtarësh, nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

10. Pas publikimit të vendimit të Gjykatës në Fletoren Zyrtare, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 7, datë 16.12.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të paraqitur nga kërkesja, duke argumentuar, ndër të tjera, se tejkalimi i afatit ligjor për shqyrtimin e rekursit të saj është rrjedhojë e disa rrethanave që përbëjnë pamundësi objektive.

11. Më datë 7.3.2022 kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 7, datë 16.12.2021, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim nga një tjetër trup gjykues i Gjykatës së Lartë (*kërkesa nr. 2*).

12. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin nr. 57, datë 20.5.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi vendimi i kundërshtuar, ndonëse përbënte rrethanë të re, duke qenë se ishte dhënë pas vendimit të kësaj gjykate, ishte konsideruar se nuk përbënte shkak që ankimi kushtetues individual i ri të kalonte për shqyrtim në seancë plenare. Sipas Mbledhjes së Gjyqtarëve, kërkesja nuk ka paraqitur ndonjë argument që të tregonte ndryshimin e situatës dhe të interesit të saj nga koha e dhënies së vendimit nr. 34, datë 1.11.2021 nga kjo Gjykatë. Në këtë situatë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka çmuar se në rastin konkret nuk ekziston ndonjë fakt ose rrethanë e ndodhur pas dhënies së vendimit të mëparshëm të Gjykatës, me rëndësi të mjaftueshme për të ndryshuar arsyet në themel të vendimarrjes së mëparshme të saj.

13. Më datë 25.4.2024, kërkesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë të re për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë, ku, ndër të tjera, ka kërkuar edhe konstatimin e statusit të viktimës gjatë procesit gjyqësor dhe shpërblimin e dëmit, si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Me shkresën nr. 2087/1 prot., datë 3.5.2024 “Për plotësim kërkesë”, kancelari i



Gjykatës së Lartë e ka njoftuar kërkesen se kërkesa e saj nuk ishte nënshkruar nga një avokat përfaqësues dhe e ka kthyer atë për plotësimin e të metave brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni të shkresës. Më datë 8.5.2024, kërkesja ka paraqitur shkresën nr. 2289, datë 8.5.2024 “Kthim përgjigje” dhe bashkëlidhur saj ka dërguar edhe autorizimin e datës 7.5.2024 të administratorit të saj për caktimin e përfaqësuesit ligjor përpara Gjykatës së Lartë. Në të njëjtën datë kërkesja ka paraqitur në atë gjykatë një kërkesë me të njëjtin objekt dhe përmbajtje si ajo e datës 25.4.2024, të nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërkohë që në të rezultoi emri i përfaqësuesit ligjor të saj, por jo nënshkrimi i tij. Kërkesa është regjistruar me nr. 2289 regjistri, datë regjistrimi 8.5.2024.

14. Ndërkohë që kërkesa ishte duke u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë, kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës duke paraqitur ankimin kushtetues individual, objekt shqyrtimi, i cili është regjistruar më datë 27.5.2024 (*kërkesa nr. 3*).

15. Pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2292, datë 30.5.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, me argumentin se mosveprimi i asaj gjykate nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive, pasi nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e procesit ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator. Për më tepër, ai kolegji ka evidentuar se çështja e kërkeses nuk përfshihet në rastet e parashikuara nga vendimi nr. 178, datë 30.5.2019, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” (*vendimi nr. 178/2019 i KLGJ-së*) dhe se kërkesja nuk ka sjellë asnjë argument nëse çështja konkrete paraqet ndonjë specifike ose rrethanë të veçantë që të justifikojë shqyrtimin e saj me përparësi, jashtë rendit kronologjik. Ndërkohë, ka sqaruar se Kolegji Civil ka filluar të shqyrtojë çështjet e regjistruara në vitin 2016 dhe se në vijim do të shqyrtohet edhe çështja objekt kërkesë, sipas rendit kronologjik.

16. Me vendimin e datës 17.7.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

17. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

17.1 *Së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj*, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë e shkresës nr. 2087/1 prot., datë 3.5.2024 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, përmes së cilës kërkohej plotësimi i kërkesës së datës 25.4.2024 së kërkeses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave, pa pasur asnjë vlerësim ose shqyrtim gjyqësor sipas dispozitave ligjore. Pra, në çështjen konkrete nuk ka pasur shqyrtim dhe vendim nga një gjyqtar në kuptim të nenit 154/a, pika 3, të KPC-së, sipas të cilit kthimi i kërkesës pa veprime bëhet nga gjyqtari i vetëm, procedurë që gjen zbatim edhe në Gjykatën e Lartë. Për analogji, bazuar në nenin 57, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, rekursi kthehet me të meta me vendim të gjyqtarit. Formulimi në nenin 399/5 të KPC-së, duke përdorur lidhëzën “nëse”, tregon se kërkesa mund të bëhet edhe nga vetë kërkuesi, por nëse bëhet nga avokati kërkohej prokurë. Interpretimi nga kancelari i Gjykatës së Lartë i nenit 474 të KPC-së në raport me nenin 399/5 të po këtij kodi është *contra legem*. Për më tepër, neni 399/5 i KPC-së është *lex specialis* për procedurat në fjalë.

17.2 *Së drejtës për një mjet efektiv për konstatimin e cenimit, dëmshpërblimin dhe përsheptimin e procedurave*, të garantuar në nenin 13 të KEDNJ-së të lidhur me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenin 42 të Kushtetutës, pasi rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 15.6.2016 dhe që prej asaj kohe, prej gati 8 vjetësh, nuk ka ende një vendimarrje prej saj. Për më tepër, mbetet e paqartë nëse Gjykata e Lartë është në dijeni të vendimit nr. 34/2021 të Gjykatës të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187/2021. Gjykata e Lartë nuk e ka objektivisht të mundur proceduralisht të zgjidhë ankesën për shkeljen e kohëzgjatjes dhe ndreqjen e pasojave në kohë brenda afatit 2- vjeçar të parashikuar nenin 399/2, shkronja “a”, të KPC-së. Në këto kushte, Gjykata e Lartë nuk përbën më mjet



efektiv për zgjidhjen e pretendimeve për vonesë të procedurave të gjykitimit.

17.3 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, në veçanti në Gjykatën e Lartë, pasi:

17.3.1 Rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 15.6.2016 dhe deri më datën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë kanë kaluar 7 vjet e 11 muaj dhe çështja nuk ka përfunduar ende, në kundërshtim me nenin 399/2 të KPC-së, ku është përcaktuar afati 2-vjeçar si afat i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve civile në Gjykatën e Lartë.

17.3.2 Nga koha e regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Lartë nuk është ndërmarrë asnjë hap procedural në drejtim të gjykitimit të çështjes, përveç veprimtarisë administrative të caktimit me short dhe/ose rishortimit të herëpashershëm të gjyqtarit relator. Ndërkohë, në tejzgjatjen e afatit nuk ka ndikuar asnjë prej rrethanave të parashikuara në nenin 399/1 të KPC-së, pasi nuk rezulton që çështja të jetë pezulluar për shkaqe ligjore ose të jetë shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuuese. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë rrethana të pamundësisë objektive në gjykim, pasi, sipas jurisprudencës së Gjykatës dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat Njeriut (*GJEDNJ*), procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilit i janë nënshtruar edhe anëtarët e Gjykatës së Lartë, nuk përbën shkak justifikues për tejkalimin e afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjeve gjyqësore.

17.3.3 Interesi ekonomik i kërkueses dhe personal-vetjak, si dhe psikosocial e shëndetësor i ortakut të vetëm të saj rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme nga tejzgjatja e procedurave gjyqësore, duke qenë se masa e sigurimit personal të arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të vetëm po e çon kërkuesen drejt falimentimit. Në kushtet kur edhe certifikata për ushtrimin e veprimtarisë është pezulluar nga Ministria e Drejtësisë, është bërë e pamundur për ortakun e shoqërisë që t'u përgjigjet kërkesave jetësore dhe bazike të familjes dhe biznesit, duke konsideruar që ai është prind i një fëmije të mitur dhe kujdeset për nënën e sëmurë.

17.4. Kërkuësja ka pasur statusin e viktimës përgjatë procesit gjyqësor si rrjedhojë e shkeljes vijuese të afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë për çështjen e themelit, si dhe cenimit të së drejtës së aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj, në përputhje me vendimin *Scordino kundër Italisë*, [GC] nr. 36813/97. Ky status është përkeqësuar edhe më shumë me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës

30.5.2024, i cili ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit dhe përshpejtimin e procedurave.

17.5 *Së drejtës së rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit*, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi dëmi është shkaktuar prej akteve të paligjshme të Gjykatës së Lartë, përkatësisht shkresave nr. 3102/1/2020 dhe nr. 2087/1/2024 të kancelarit të asaj gjykate, si dhe cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Në këto kushte, asaj i takon dëmshpërblimi i arsyeshëm në përputhje me nocionin *restitutio in integrum*.

18. **Subjekti i interesuar, BKT-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

18.1 Në lidhje me *legjitimitimin e kërkueses*, në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, ajo, deri në momentin që i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, nuk ka pasur një vendim përfundimtar nga Gjykata e Lartë, e cila të jetë shprehur më pas me vendimin nr. 00-2024-2292, datë 30.5.2024. Për rrjedhojë, kërkuësja nuk legjitimohet në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, për sa kohë që çështja ishte duke u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë.

18.2 Në lidhje me *themelin e çështjes*, kërkesa e kërkueses për shpërblimin e dëmit është e pabazuar, pasi një kërkesë e tillë i drejtohet gjykatës së shkallës së parë ku ka qendrën organi ndaj të cilit është konstatuar shkelja. Përveç kësaj, nuk mund të kërkohej në të njëjtën kohë konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe shpërblimi i dëmit për shkak të kësaj shkeljeje, pasi ato janë dy procese të ndara. Shpërblimi i dëmit në këto raste kërkohej nëpërmjet kërkesëpadisë dhe vetëm pasi është dhënë një vendim pranimit për konstatimin e shkeljes.

18.3 Pretendimi për shkeljen e afatit të arsyeshëm duhet rrëzuar, pasi kërkuësja e ka bazuar kërkesën e saj vetëm në kriterin “kohë”, por jo në kriteret e tjera. Lidhur me kriterin e sjelljes së autoriteteve është vërtetuar se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Gjykata duhet të mbajë në konsideratë se ajo gjykatë është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm dhe se referuar vendimit nr. 178/2019 të KLGJ-së çështja nuk përfshihet në rastet e rregulluara në të. Përveç kësaj, kërkuësja nuk ka sjellë asnjë argument nëse çështja konkrete paraqet ndonjë specifikë ose rrethanë të veçantë që



të justifikojë shqyrtimin e saj me përparësi jashtë rendit kronologjik.

19. **Subjekti i interesuar, KESH-i**, ndonëse është njoftuar rregullisht, nuk ka paraqitur shpjegime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

20. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

21. Kërkuësja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për të cilin ka ngritur pretendime dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

22. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Për sa u përket kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që mund t'i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e neneve 399/2 e

vijues të KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues. Gjykata e ka konsideruar të shteruar këtë kriter si në rastet kur Gjykata e Lartë është shprehur me vendim, ashtu edhe në rastet e mungesës së një vendimi (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Subjekti i interesuar, BKT-ja, ka prapësuar se kërkesa e kërkuësës nuk përmbush kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi deri në momentin që i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave, nuk ka pasur një vendim përfundimtar nga Gjykata e Lartë për këtë çështje. Kjo e fundit është shprehur pas paraqitjes së kërkesës në Gjykatë me vendimin nr. 00-2024-2292, datë 30.5.2024.

24. Gjykata konstaton se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Lartë më datë 25.4.2024 me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave. Pa kaluar afati ligjor 45-ditor për shqyrtimin e këtyre lloj kërkesave në Gjykatën e Lartë, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual më datë 27.5.2024, duke pretenduar se kërkesa drejtuar Gjykatës së Lartë nuk do të ishte një mjet efektiv që do t'i shërbente qëllimit të saj, pasi pas pothuajse 8 vjetësh nga regjistrimi i rekursit nuk ka ende një vendimarrje për çështjen civile të saj. Ndërkohë, më pas, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2292, datë 30.5.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Prandaj, në këto kushte, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i interesuar, BKT-ja, Gjykata vlerëson se kërkuësja e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000.

25. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, Gjykata vëren se jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Gjykatës së Lartë është i datës 30.5.2024 dhe në kushtet kur ankimi kushtetues individual është paraqitur dhe regjistruar në Gjykatë përpara dhënies së vendimit të kundërshtuar (më datë 27.5.2024), vlerësohet se kërkesa është paraqitur në respekt të afatit ligjor 4-



mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

26. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave, konstatimin e statusit të viktimës përgjatë procesit gjyqësor, si dhe të drejtën për rehabilitim dhe dëmshpërblim në përputhje me ligjin.

27. Për pretendimin e kërkuësës për dëmshpërblim për shkak të tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, subjekti i interesuar, BKT-ja, ka prapësuar se ai është i pabazuar, pasi një kërkesë e tillë i drejtohet gjykatës së shkallës së parë dhe se ajo nuk mund të bëhet njëkohësisht me kërkesën për shkeljen e afatit të arsyeshëm, pasi shpërblimi i dëmit në këto raste kërkohet nëpërmjet kërkesëpadisë dhe vetëm pasi është dhënë një vendim pranimit për konstatimin e shkeljes.

28. Gjykata, sikurse ka theksuar edhe në vendimin e saj të mëparshëm ndaj kërkuësës (*shih vendimin nr. 34, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), bazuar në praktikën e GJEDNJ-së në raste të ngjashme, vlerëson se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, ky pretendim i kërkuësës nuk bën pjesë në juridiksionin e saj, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

29. Kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj si rrjedhojë e veprimeve të kancelarit të Gjykatës së Lartë për kthimin pa veprim të kërkesës së saj të parë drejtuar asaj gjykate për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit të saj.

30. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se kthimi pa veprim i kërkesave drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit nga kancelari i kësaj gjykate, bazuar në dispozitat që përcaktojnë nënshkrimin nga avokati të rekursit, përbën formalizëm të tepruar dhe kthen një rregull garantues procedural në një mjet pengues të aksesit në Gjykatën e Lartë. Po sipas Gjykatës, veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës). Gjykata e Lartë ka detyrimin të sillt

në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtimin të mos humbasë qëllimin e vetë dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv (*shih vendimet nr. 58, datë 17.9.2024; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se pas kthimit pa veprim nga kancelari i Gjykatës së Lartë të kërkesës së datës 25.4.2024, kërkuësja e ka paraqitur sërish atë më datë 8.5.2024 dhe pas shqyrtimit të saj, me vendimin nr. 00-2024-2292, datë 30.5.2024, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që veprimet e kancelarit të kenë sjellë pasoja në drejtim të paraqitjes së kërkesës për konstatim dhe as nuk ka rezultuar që të kenë shkaktuar ndonjë kohëzgjatje të tillë që të kenë ndikuar në kohëzgjatjen tërësore të procedurave në Gjykatën e Lartë, të cilat kanë përfunduar brenda afatit ligjor 45-ditor të parashikuar nga KPC-ja. Nga ana tjetër, në kushtet kur në lidhje me këtë kërkesë Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim me vendim, Gjykata çmon se kërkuësja e ka realizuar të drejtën e saj të aksesit në atë gjykatë, ndaj vlerëson se pretendimet e saj për cenimin e kësaj të drejte nuk janë të argumentuara në këndvështrimin kushtetues.

32. Në kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkuësja ka pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit nga Gjykata e Lartë të procesit civil të kërkuësës, ashtu edhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave dhe konstatimin e statusit të viktimës, të cilat, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Duke pasur parasysh natyrën e tyre, por edhe thelbin e pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata çmon t'i analizojë ato në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

33. Kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka tejkaluar ndjeshëm afatin e arsyeshëm në gjykimin e çështjes, e cila është regjistruar në atë gjykatë më datë 15.6.2016 dhe ende nuk është gjykuar. Ajo gjykatë nuk rezulton të ketë pezulluar çështjen për shkaqe ligjore ose që ajo të jetë shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuëse, si dhe nuk



janë shfaqur rrethana të pamundësisë objektive për procedim, sipas nenit 399/2, pika 3, të KPC-së. Prej kësaj gjykate nuk është ndërmarrë asnjë hap procedural në drejtim të gjykimit të çështjes, përveç shortimit dhe rishortimit të herëpashershëm të gjyqtarit relator. Çështja që kërkohet të zgjidhet nga ajo gjykatë nuk ka asnjë lloj vështirësie që të krijojë vonesa, prandaj duhet ta zgjidhë atë sa më shpejt të jetë e mundur. Prej kësaj tejzgjatjeje, interesi ekonomik i kërkuësës dhe personal-vetjak, si dhe psikosocial e shëndetësor i ortakut të vetëm të saj rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme, duke qenë se masa e sigurimit personal të arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të saj po e çon kërkuësen drejt falimentimit.

34. Subjekti i interesuar, BKT-ja, ka prapësuar se kërkuësja e ka bazuar kërkesën e saj vetëm në kriterin “kohë” dhe jo në kritere të tjera. Lidhur me kriterin e sjelljes së autoriteteve, nuk është vërtetuar se mosveprimi i gjykatës të ketë ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Gjykata duhet të mbajë në konsideratë se Gjykata e Lartë është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm dhe se referuar vendimit nr. 178/2019 të KLGJ-së çështja nuk përfshihet në rastet e rregulluara në të. Përveç kësaj, kërkuësja nuk ka sjellë asnjë argument nëse çështja konkrete paraqet ndonjë specifikë ose rrethanë të veçantë që të justifikojë shqyrtimin e saj me përparësi jashtë rendit kronologjik.

35. Neni 42 i Kushtetutës përcakton se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 37, datë 7.5.2024; nr. 21, datë 4.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 28.5.2014, duke kërkuar nga e paditura, BKT-ja, shpërblim për dëmin pasuror e jopasuror të pretenduar, fitimin e munguar, si dhe për kamatat

ligjore përkatëse. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuësës si të pambështetur në ligj. Kërkuësja ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, më datë 20.5.2016 kërkuësja ka paraqitur rekurs, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11118-02028-00-2016, më datë 15.6.2016. Nga momenti i paraqitjes së kërkesëpadisë (28.5.2014) deri në shqyrtimin e saj në Gjykatë kanë kaluar rreth 10 vjet, ndërsa nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë (15.6.2016) kanë kaluar rreth 8 vjet dhe ende nuk ka një vendimmarrje për të.

37. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjes civile, KPC-ja, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

38. Në vështrim të standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkuësës i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuësit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuësi (*shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në lidhje me *sjelljen e kërkuësës*, Gjykata vëren se, sikurse ka pranuar edhe Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 12 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), nuk konstatohet ndonjë sjellje e kërkuësës në veçanti ose e palëve në përgjithësi që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë e deri në shqyrtimin e saj në Gjykatë, nuk është kryer ndonjë veprim procedural. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që kërkuësja ose palët në proces të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

40. Për sa i takon *kompleksitetin të çështjes*, Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile e cila rregullohet nga Kodi Civil. Si palë



në këtë proces janë kërkuësja, BKT-ja dhe KESH-i, persona juridikë dhe në objektin e padisë kërkohet shpërblimi i dëmit pasuror e jopasuror që kërkuësja pretendon se i është shkaktuar nga BKT-ja për shkak të mosdebitimit të llogarisë së debitorit (CEZ-it) në favor të kreditorit (KESH-it), i cili është klient i kërkuësës. Për përllogaritjen e dëmit të pretenduar është kryer edhe ekspertizë ekonomike. Gjykata, në vijim, konstaton se procedurat përpara gjykatës së shkallës së parë kanë zgjatur përafërsisht 11 muaj, periudhë gjatë së cilës janë zhvilluar 14 seanca gjyqësore dhe në përfundim ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuësës. Po kështu, procedurat përpara Gjykatës së Apelit Tiranë kanë zgjatur rreth 12 muaj dhe në përfundim ajo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

41. Gjykata, megjithatë, vlerëson të theksojë se kompleksiteti i çështjes nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme. Me fjalë të tjera, edhe pse kjo çështje, referuar objektit të saj, numrit të palëve ndërgjyqëse dhe volumit të akteve shkresore e dokumenteve të administruara në gjykim, mund të mbartë kompleksitet gjatë gjykimit të saj në gjykatat e faktit, kjo mund të mos jetë e tillë në Gjykatën e Lartë, për shkak të natyrës së atij gjykimi dhe procedurës së gjykimit në dhomën e këshillimit, si dhe funksionit të saj si gjykatë e ligjit, pavarësisht kuadrit ligjor të zbatueshëm dhe ndryshimeve të vazhdueshme e të shpeshta përgjatë viteve si të akteve ligjore, ashtu edhe të atyre nënligjore. Pra, gjykimi në gjykatën e ligjit nuk mund të thuhet se paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti si në shkallët e tjera të gjykimit.

42. Pavarësisht se në vendimin e saj të mëparshëm (*shih vendimin nr. 34, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*) Gjykata ka vlerësuar se mosmarrëveshja objekt gjykimi paraqet elemente kompleksiteti, duke marrë në konsideratë se nga ai vendim kanë kaluar tashmë edhe pothuajse 3 vjet, si dhe nisur nga natyra e gjykimit në Gjykatë të Lartë dhe për sa kohë që vetë ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përsheptimin e procedurave mbi konsiderata që lidhen me rrethanat objektive, referuar situatës së përgjithshme në sistemin gjyqësor, Gjykata vlerëson se edhe pse në dukje

mund të ketë elemente kompleksiteti, kjo nuk ka ndikuar në kohëzgjatjen e procesit.

43. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata vëren se çështja e kërkuësës është në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Lartë prej tashmë pothuajse 8 vjetësh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë është pothuajse 10 vjet. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e kërkuësës për konstatimin e cenimit dhe përsheptimin e procedurave, rezulton se çështja e saj civile figuron në fazë studimi në atë gjykatë dhe se Kolegji Civil ka filluar të shqyrtojë çështjet e regjistruara në vitin 2016, prandaj në vijim edhe çështja civile e kërkuësës do të shqyrtohet në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve. Gjykata e Lartë ka çmuar se mosveprimi i saj nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili është ndërruar disa herë, por si rrjedhojë e situatës aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor për shkak të reformës në drejtësi (*shih paragrafët 14 dhe 15 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

44. Ndërkohë, nga informacioni zyrtar i marrë nga Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 21761/1, datë 15.10.2024, rezulton se deri në atë datë ngarkesa e secilit gjyqtar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka qenë si vijon: A.K. ka në ngarkim 2320 çështje; E.P. ka në ngarkim 2646 çështje; M.B. ka në ngarkim 1754 çështje; E.Dh. ka në ngarkim 1917 çështje; V.Ç. ka në ngarkim 1744 çështje dhe V.K. ka në ngarkim 1743 çështje.

45. Gjithashtu, nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, fillimisht, ka rezultuar se më datë 22.8.2024 është planifikuar data 18.9.2024, ora 11:50 për shqyrtimin e rekursit të kërkuësës në dhomën e këshillimit, me gjyqtare relatore M.B. Ndërsa nga informacioni i marrë më datë 12.11.2024 nga ajo gjykatë ka rezultuar se çështja është planifikuar për t'u shqyrtuar në dhomën e këshillimit, por nuk është shqyrtuar ende, për shkak të kërkesave për dorëheqje të anëtarëve të trupit gjykues. Në vijim, po nga të dhënat e faqes zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, ka rezultuar se më datë 19.11.2024 është planifikuar sërish shqyrtimi i rekursit të kërkuësës në dhomën e këshillimit, kësaj here më datë 27.11.2024, ora 12:00.

46. Bazuar në treguesit e mësipërm, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuësës lidhet me ngarkesën në Gjykatën e Lartë



shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Në këtë drejtim, Gjykata thekson në mënyrë të përsëritur se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja, në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Sa më sipër, përtej efekteve që ka sjellë zbatimi i reformës në drejtësi në afatin e shqyrtimit të çështjeve, duke qenë se rekursi i kërkuar është programuar për shqyrtim në dhomën e këshillimit, por nuk është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë më datë e programuar për shkak të kërkesave për dorëheqje të paraqitura nga anëtarët e trupit e gjykues, duket se së fundmi në kohëzgjatjen e afatit kanë ndikuar edhe aspektet procedurale për shqyrtimin e çështjes civile të kërkuarës.

48. Për sa i takon rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuarja, sipas kërkuarës, ajo lidhet me interesin ekonomik të saj dhe atë personal-vetjak, si dhe psikosocial e shëndetësor të ortakut të vetëm të saj, që rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme nga tejzgjatja e procedurave gjyqësore për shkak se masa e arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të vetëm, po e çon kërkuarën drejt falimentimit dhe e pamundëson ortakun e shoqërisë që t'u përgjigjet kërkesave jetësore dhe bazike të familjes dhe biznesit.

49. Gjykata ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit, nisur nga interesi veçanërisht i lartë i kërkuarës. Disa çështje që

lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi. Të tilla janë çështjet që kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuarës në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024, nr. 6, datë 16.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Për sa i përket vlerësimit se çfarë përbën rrezik për kërkuarën, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

51. Konkretisht, sipas njërit qëndrim, kërkesa duhet pranuar, pasi koha e gjykimit të çështjes së kërkuarës ka qenë thelbësore në drejtim të njohjes dhe eventualisht edhe të ushtrimit të së drejtës së pretenduar nga ajo, ndaj tejzgjatja e gjykimit në Gjykatën e Lartë ka bërë që pretendimet e saj, edhe nëse njihen gjyqësisht, të mbeten pa vlerë. Në këtë kuptim, në rrethanat e rastit konkret, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuarës në raport me rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rëndësinë e asaj çfarë rrezikon ajo, ka tejkaluar një kufi kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues, prandaj është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm¹.

52. Ndërsa, sipas qëndrimit tjetër, kërkesa duhet rrëzuar, pasi, sikurse kanë arsyetuar edhe gjykatat e faktit, nuk ka rezultuar që kërkuarja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së paditur, për të cilat pretendon se kanë shkaktuar moslidhjen në vijimësi të kontratave të mëtejshme të shërbimit me shoqëritë KESH dhe OST, duke qenë se nuk u vërtetua të jenë bërë kërkesa ose marrëveshje paraprake për ndonjë kontratë shërbimi për urdhra ekzekutimi të tjera. Në këtë kuptim, në rastin konkret, edhe pse ka një tejzgjatje të procesit, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për

¹ Votuan për pranimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të afati të arsyeshëm gjyqtarët Marsida Xhafertilari, Sandër Beci, Marjana Semini dhe Fiona Papajorgji.



interesin e kërkukses, numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë në pritje për t'u gjykuar, si dhe faktin se ajo gjykatë ka ndërmarrë veprime konkrete për vënien në lëvizje të procesit civil të kërkukses, duke planifikuar shqyrtimin në dhomën e këshillimit të saj, nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.²

53. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkukses konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 21.11.2024.

Shpallur, më 19.12.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

NJOFTIM

Nr. 18821, datë 24.12.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

“Marrëveshja Ndërqeveritare (IGA) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës mbi Kontributin në Zbatimin e Projekteve Prioritare në Shqipëri”, nënshkruar në Paris, më 12.4.2024, ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

² Votuan për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Ilir Toska dhe Genti Ibrahimi.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

